



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr 158 Datë 30.12.08

Për miratimin e fondit prej 200.000 Lekësh për dekorin e qytetit

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit "Për miratimin e fondit prej 200 000 Lekësh për dekorin e qytetit", Nw zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.2008 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008", si dhe Ligjin nr. 9936. datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin shtese prej 200 000 lekësh nga fondi rezerve i Bashkisë për dekorin e qytetit sipas kesaj strukture buxhetore

Pakesohet 00 04980 05 Art 609 0000 - 200 000 (Bashkia)

Shtohet 00 06260 05 Art 602 0000 + 200 000 (Ndermarrja e Sherbimeve Publike)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit, Ndermarrja e Sherbimeve Publike dhe Drejtoria e Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Raimonda NASE